

... të fëmijëve në transmetime
... esën e Autoritetit të Med
... ive që prej muajit prill ka
... tur më **Buletini i** shumë
... mendime **Lëshillit të** për
... cilave kanë **Ankesave.** N
... të drejtë të kërkojë, të het
... të marrë dhe të ndajë info
... dhe ide, pa asnjë lloj censu
... dios, tu dhe mjeteve të tjer
... kimit audioviziv apo ndon
... tjetër bazuar në përzgjed
... m nëse këtë e bën në kuad
... timit të sundin
... tave të njeriut.
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

NR. 10

Dërbajtja

Hyrja	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave	06
SEKSIONI I	
Ankesa me subjekt cenimi i rregullave të etikës	09
SEKSIONI II	
Ankesa me subjekt cenimi i të drejtave të fëmijëve.....	23
SEKSIONI III	
Ankesa me objekt jashtë juridiksionit të Ama-s	29
SEKSIONI IV	
Ankesa me objekt të ndryshëm	34

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Zbatimi i Ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, si dy binarë në të cilët zhvillojnë veprimtarinë mediat audiovizive në Shqipëri, zbatimi mbetet ende një sfidë, ndonëse, Autoriteti i Mediave Audiovizive vijon të mbështesë mediat në misionin e tyre, duke u kërkuar llogari për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si një strukturë e posaçme që monitoron zbatimin e Kodit të Transmetimit dhe shqyrton ankesat referuar përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, evidentoi se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, të cilit i dedikohet Buletini i 10-të, më së shumti janë shqyrtuar ankesa ku pretendohet cenimi i rregullave të etikës dhe dinjitetit në përgjithësi, cenimi i të drejtave të miturve, por dhe ankesa me objekt të ndryshëm.

Numri më i lartë i ankesave, lidhet me cenimin e dinjitetit, ndaj dhe AMA në trajtimin e tyre, u kujtoi OSHMA-ve parimet themelore të veprimtarisë së tyre në respektimin e "së drejtës për informacion, bindjeve politike e besimeve fetare, personalitetit, dinjitetit dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut..."(neni 4, pika 1/b, Ligji Nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar) si edhe parimet e Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, i cili detyron mediat audiovizive të respektojnë të drejtën për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke përcaktuar konkretisht se: "Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë". (Seksioni 3, "E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale", pika 3.1).

Këshilli i Ankesave, një strukturë që shërben edhe si një urë komunikimi mes ankuesve dhe OSHMA-ve, u kujtoi këtyre të fundit, se referuar dispozitave të sipërpërmendura, ato detyrohen

të zbatojnë standardet më të larta profesionale, për të garantuar, që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale.

Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al.

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "**Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit**", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: info@ama.gov.al. Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtorinë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet **Buletini i Këshillit të Ankesave**. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.



Ankesa me
objekt
"Cënimin e
rregullave
të etikës
dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga:

A.K

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Top Channel	Edicione informative	20.09.2020
TV Klan	Edicione informative	20.09.2020
Vizion Plus	Edicione informative	20.09.2020
TV News 24	Edicione informative	20.09.2020
Ora News	Edicione informative	20.09.2020
Disa portale	Shkrime	<i>vijoi edhe në 2021</i>

1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasi A.K i drejtoi Këshillit të Ankesave një ankesë, përmes së cilës pretendonte se në edicionet informative të pesë televizioneve si dhe në disa portale, më datë 20.09.2020 ishte publikuar informacion i pasaktë, duke i cenuar rëndë dinjitetin dhe imazhin. Lajmi i referohej identifikimit të autorit të dyshuar për vrasjen e shtetasit I.B, ngjarje e ndodhur në Durrës. Asokohe policia arrestoi si të dyshuar shtetasin A.K. Sipas ankuesit, lajmi në fjalë ishte shoqëruar me fotografinë e tij, marrë nga profili në rrjetin social "Facebook". Sipas pretendimeve të tij në lajm ishte publikuar fotoja e tij edhe pse A.K nuk kishte asnjë lidhje me autorin e dyshuar të ngjarjes, përveç gjeneraliteteve të njëjta (emër dhe mbiemër). Ankuesi pretendonte se ngatërimi i identitetit në lajmet e raportuara për ngjarjen e sipërcituar kishte "sjell dëm të pariparueshëm në imazhin e tij".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi me kujdes materialin e plotë, i bëri me dije ankuesit fushën e zbatimit të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2 ("Fusha e zbatimit"), i cili përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar", portalet/media online, rrjetet ose faqet

sociale, të cilat janë jashtë objektivit të punës të përcaktuar nga ligji i sipërcituar.

Ndërsa, sa u përket mediave audiovizive, Këshilli i Ankesave u nisi OSHMA-ve një shkresë për verifikim dhe korrigjim informacioni.

Subjekti audioviziv "TV Klan", informoi Këshillin e Ankesave se "ka marrë të gjitha masat për mospublikimin e fotove të shtetasit A.K".

Subjekti audioviziv "Top Channel", informoi Këshillin e Ankesave se "në edicionet informative... nuk ka rezultuar përdorim i fotos së shtetasit A.K. në faqen web është korrigjuar që në momentet e para, pas sinjalizimeve direkte. Verifikimet janë bërë me burime nga Policia e Shtetit".

Subjekti audioviziv "Ora News" informoi Këshillin e Ankesave se "për shkak të një keqkuptimi, kronika e montuar ka kaluar me një foto të gabuar për shtetasin A.K si shkak i ngatërresës së krijuar nga një burim i gazetarit... e gjitha kjo, ka ndodhur si gabim njerëzor, pa asnjë qëllim dashakeqës. Nga ai moment e më pas redaksia nuk e ka shfaqur më foton dhe është hequr menjëherë nga transmetimi dhe nga faqja web e televizionit".

Ndërsa, subjekti audioviziv "Vizion Plus" informoi Këshillin e Ankesave se "nuk rezultonte që Shoqëria "Media Vizion", sh.a të kishte përdorur foton e tij, në pasqyrimin e lajmit që përcillte ngjarjen kriminale të ndodhur në qytetin e Durrësit, në datën 19.09.2020, por vetëm të viktimës".

Këshilli i Ankesave pasi monitoroi sërish materialet përkatëse filmike për rastin në fjalë,

konstatoi korrigjimin e informacionit, në rastet kur ai kishte qenë i gabuar ("Klan" dhe "Ora News"). Konkretisht: "TV Klan" e kishte korrigjuar informacionin që në momentin e parë, "Top Channel" e kishte korrigjuar informacionin në faqen web, "News 24" dhe "Vizion Plus" e kishin pasur informacionin korrekt, ndërsa subjekti audioviziv "Ora News" njoftoi se "ngatërimi i fotos kishte ndodhur për një gabim njerëzor".

Vendimi i Këshillit të Ankesave u ankimua, nga ankuesi, pranë Bordit të AMA-s, duke kërkuar verifikimin e shkeljeve të raportuara dhe vlerësimin zyrtar. Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi ankesën si dhe dëgjoi relacionin e Këshillit të Ankesave. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha materialeve, AMA rrëzoi kërkesën e ankuesit, duke vlerësuar se qëndrimi i mbajtur nga Këshilli i Ankesave kishte qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga: **K.G**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Report TV	Emisioni "Pa gjurmë"	15.01.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, i erdhi një ankesë për emisionin "Pa gjurmë", transmetuar në "Report TV", më datë 04.12.2020. Sipas ankueses gjatë këtij emisioni ishin transmetuar, pa autorizim "foto të marra nga profili i saj në rrjetet sociale" dhe ishin "shpërndarë informacione të pavërteta dhe dashakeqëse".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi pamjet filmike, Këshilli i Ankesave i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve bazuar në nenin 51, pika 1 e ligjit të medias ku përcaktohet se: "OSHMA-ja është e detyruar të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e transmetuara prej tij".

Në pretendimet e paraqitura nga OSHMA-ja thuhej se i kishin kërkuar ndjesë publike palës ankuese dhe se ishte fshirë çdo foto dhe video në të gjitha kanalet dhe format e kontaktit në "Youtube" dhe "Facebook".

Konkretisht, nga televizioni u bë me dije, se kishte: "...transmetuar me zë dhe figurë të gjithë përmbajtjen, si dhe është lexuar me transparencë të plotë kjo letër e dërguar nga K.G, e cila ka sqaruar se nuk është ajo personi që kërkohet në emision. Është kërkuar falje publike dhe përgënjeshtroar ky lajm, gjithashtu konform shqetësimeve të ngritura".

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi se OSHMA-ja kishte respektuar të drejtën e përgjigjes sipas kërkesave të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga: **Familjarë të shtetasit J.O**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Berati TV	Edicione informative	10.02.2021
Apollon TV	Edicione informative	10.02.2021
TV News 24	Edicione informative	10.02.2021
TV Fax News	Edicione informative	10.02.2021
RTV Ora	Edicione informative	10.02.2021
Syri TV	Edicione informative	10.02.2021
TV Abc News	Edicione informative	10.02.2021
Disa portale	Shkrime	10.02.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Familjarët e shtetasit J.O i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave, pasi më datë 26.01.2019 në kronikat e transmetuara nga gjashtë media audiovizive, si dhe në shkrimet e disa portaleve, ishin publikuar gjeneralitetet e plota të familjarit të tyre si dhe fotoja e tij, përfshirë vendin ku tentoi vetëvrasjen dhe detaje të tjera. Ngjarja i referohej tentativës për vetëvrasje të familjarit të tyre, ardhur si shkak i një situatë të rënduar psikologjike, pas kalimit të Covid -19 dhe efektit të medikamenteve.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi pamjet e transmetuara dhe vlerësoi se, ato ishin pamje sensitive dhe private. Ai u kujtoi OSHMA-ve parimet themelore të veprimtarisë së tyre, ku ndër të tjera specifikohet se "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut..."(neni 4, pika 1/b, ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar).

Gjithashtu, edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, detyron OSHMA-të të respektojnë të drejtën për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale: "Shpërndarja e

informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale..." (Seksioni 3, "E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale", pika 3.1).

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave kërkoi ndërprerjen e transmetimit të mëtejshëm të pamjeve për tentativën e vetëvrasjes së z.J.O dhe të publikimit të gjeneraliteteve të plotë të tij.

Ankesa e paraqitur nga: **B.Xh**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Top Channel	Emisioni "Shqipëria live"	18.02.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Ankuesi iu drejtua Këshillit të Ankesave me pretendimin, se gjatë emisionit "Shqipëria live", transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 01.02.2021 në orën 12:45, ishin dhënë "dy intervista; e para, me të birin e të moshuarës që dyshohej të jetë viktimë e një abuzimi edhe seksual, dhe e dyta, me vetë 89 vjeçaren". Sipas ankesës, gjatë intervistës me të birin e të moshuarës, gjatë gjithë kohës, 89 vjeçarja qëndronte e ekspozuar në ekran, ndërkohë që nuk ishte marrë asnjë masë teknike për mbulimin e fytyrës së saj.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi pamjet filmike, Këshilli i Ankesave konstatoi se, mbulimi i fytyrës ndodhte gjatë intervistimit të së moshuarës, por kjo masë nuk kishte më vlerë përse kohë që në pjesën e intervistës me të birin e 89-vjeçares, kjo e fundit qëndronte gjatë gjithë kohës në ekran, prapa shpinës së djalit të saj dhe tërësisht e identifikueshme.

Këshilli i Ankesave vlerësoi rolin e medias në denoncimin e dukurive të tilla sociale, por sugjeroi që ato të trajtoheshin brenda normave ligjore dhe etike.

Referuar nenit 33 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, OSHMA-të detyrohen që në transmetimet e tyre "të mos cenojnë dinjitetin dhe të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe". (Detyrimet e OSHMA-ve", pika dh).

Gjithashtu, edhe në Kodin e Transmetimit përcaktohet se "Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre,

garantojnë e respektojnë lirinë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale" (Seksioni1, Parimet Themelore, pika 1.1), si dhe "Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut", (Seksioni 1, Parimet themelore, pika 1.3). Bazuar në sa më sipër, AMA tërhoqi vëmendjen dhe i kërkoi zbatimin e normave ligjore dhe etike në transmetimet e ardhshme. Gjithashtu, AMA kërkoi fshirjen e materialit përkatës nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **A.Gj**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Disa televizione Disa portale	Edicione informative Shkrime	11.03.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, mori një ankesë nga shtetasja A.Gj e cila pretendonte se në portale dhe mediat audiovizive ishte publikuar lajmi i ndalimit të saj nga Policia Gjyqësore e Drejtorisë Vendore Tiranë, nën akuzën e kryerjes së veprave penale "Shpërdorim detyre" dhe "Falsifikim dokumentash", në kohën që ankuesja punonte si juriste në një nga drejtoritë rajonale të ALUIZNI-t. Sipas ankueses lajmi përmbante pasaktësi sepse "pas trajtimit të çështjes, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë kishte konstatuar se nuk kishte patur veprë penale si dhe kishte kërkuar lirimin e saj. Ndërkohë çështja ishte pushuar".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Në materialet e ankesës përfshiheshin linqet e mediave që kishin transmetuar /publikuar lajmin, nga ku rezultonte se lajmi ishte publikuar në 23 syresh, nga të cilat 21 portale, media online dhe rrjete sociale dhe vetëm 2 linqe mediash audiovizive. Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, i shqyrtoi materialet përkatëse dhe në bazë të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2 (Fusha e zbatimit) përcakton se: "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre", mediat e cituara nga ankuesja nuk janë në objektin e punës së AMA-s.

Sa u përket mediave audiovizive, pavarësisht se lajmi bazohej në një burim zyrtar të institucioneve ligjzbatuese në vend, Këshilli i Ankesave rekomandoi, se ankuesja mund t'u kërkonte OSHMA-ve ushtrimin e së drejtës së

përgjigjes, bazuar kjo në nenin 53, pika 1, i ligjit të medias.

Ankesa e paraqitur nga: **G.C**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Report TV	Edicion informativ	11.03.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, mori një ankesë nga shtetasi G.C, i cili pretendonte se në televizionin "Report TV" ishte transmetuar një lajm i pavërtetë lidhur me shkakun e humbjes së jetës së vëllait të tij.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi ankesën, Këshilli i Ankesave, referuar nenit 51 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga OSHMA-të", i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e z.G.C.

Ankesa e paraqitur nga: **B.SH**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
RTV "Ora News"	Edicion informativ	09.04.2021
Pamfleti	Shkrime	09.04.2021
Shqiptarja.com	Shkrime	09.04.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Ankuesi B.Sh pretendonte se në edicionet e lajmeve në televizionin "Ora News", në datat 23.03.2021 dhe 25.03.2021 ishin transmetuar informacione "me përmbajtje jo të vërtetë dhe me tituj që kanë cenuar rëndë dinjitetin". Ankuesi gjithashtu kërkonte marrjen e masave ndaj dy portaleve, pas shkrimeve të publikuara në to, pasi pretendonte, se përmbanin informacione të pavërteta dhe që cenonin imazhin e tij.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi ankesën dhe materialin shoqëruar të saj, Këshilli i Ankesave referuar ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (Neni 2, Fusha e zbatimit), sipas të cilit: "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre", iu përgjig ankuesit se (portalet online) janë jashtë juridiksionit të AMA-s.

Sa u takon kronikave në edicionet informative transmetuar nga televizioni "Ora News", Këshilli Ankesave evidentoi se "Raportimet apo kronikat informative të transmetuara rezultojnë korrekte, duke iu referuar materialeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe konform normave ligjore dhe etike të medias. Informacionet e pasqyruara iu referoheshin dokumenteve apo edhe deklaratave të personave të përfshirë në ngjarje".

Pas konkluzioneve të Këshillit të Ankesave, ankuesi B.Sh i drejtoi AMA-s një "Notë protes-

te", ku shprehte pakënaqësitë e tij për vendim-marrjen e KA-së, teksa vijonte të pretendonte se "informacionet e publikuara në media ishin të pavërteta dhe të përdorura për qëllime të kundërligjshme".

Ankesa e paraqitur nga:

E.Ç

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Top Channel**Emisioni "Open"****09.04.2021**

1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasi E.Ç drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, për emisionin "Open", transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 06.04.2021. Ankuesi pretendonte se në emision ishin përdorur shprehje diskriminuese ndaj komunitetit rom, konkretisht "shtet harixhinjsh". Shprehja ishte përdorur nga një prej të ftuarve në studio për të ilustruar mendimin e tij mbi mënyrën se si ishte kryer, deri në ato momente, procesi i vaksinimit anti Covid-19 në Shqipëri.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi ankesën, Këshilli i Ankesave evidentoi se, ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i detyron OSHMA-të që në transmetimet e tyre "të mos cenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut", (neni 33, pika 1, germa ç) dhe të mos transmetojnë "përmbajtje që nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi" (neni 32, pika 4).

Gjithashtu edhe Kodi i Transmetimit, në pikën 1.5 sanksionon se "Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve", ndërsa në pikën 4.8, se "Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqësi: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose çdo shkak tjetër".

Bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Au-

diovizive i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit si dhe kërkoi korrektimin e materialit filmik në kanalën zyrtarë në "Youtube".

Ankesa e paraqitur nga:

Studio Ligjore, përfaqësuese e E.S

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV "Klan"**Rubrika "Shihemi në gjyq"****29.04.2021**

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave (AMA) mori një ankesë nga S.T, përfaqësuese me prokurë e shtetases E.S e cila pretendonte se në rubrikën "Shihemi në gjyq" të emisionit "E diela shqiptare", të datës 07.03.2021 ishte trajtuar gjendja e saj familjare. Sipas ankuses në emision, ndër të tjera ishte cenuar e drejta e jetës private, i ish-in shkelur të drejtat themelore kushtetuese si dhe të drejtat themelore të fëmijës së mitur E.P.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave iu drejtua me një shkresë Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të OSHMA-së, duke i kërkuar paraqitjen e pretendimeve mbi rastin në fjalë.

OSHMA-ja i vuri në dispozicion Këshillit të Ankesave sqarimet e drejtueses së emisionit zj. E.Ç, e cila deklaronte se kishte vepruar sipas rregullave të ndërmjetimit, teksa shprehte gadishmërinë për të dëgjuar palën ankuese, ndryshe nga pretendimi i kësaj të fundit.

Pas paraqitjes së pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave kërkoi organizimin e një seance dëgjimore mes palëve, në datën 09.06.2021, në zyrat e Autoritetit të Mediave Audiovizive, referuar ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, pika 6, që parashikon se "... gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët". Në seancën dëgjimore e konfirmoi pjesëmarrjen pala ankuese, por jo drejtuesja e emisionit znj.E.Ç. Edhe pas kësaj, Këshilli i Ankesave vijoi me shqyrtimin e ankesës dhe këqyrjen e materialeve filmike të emisionit "Shihemi në gjyq". Në përfundim, Këshilli i Ankesave konstatoi shkeljen e kërkesave të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit.

Pavarësisht shpjegimeve të znj.E.Ç, u kosnatua, se

gjatë programit nuk ishte marrë parasysh interesi më i lartë i fëmijës, sipas përcaktimeve ligjore dhe normave etike, që sigurojnë mbrojtjen e të miturve. Neni 4 i ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", përcakton se, "transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e disa parimeve, ndër të cilët "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton panashmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve" (pika 1, germa b).

Edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar nga AMA me vendimin nr.228, datë 11.12.2017 përcakton qartësisht detyrimet e OSHMA-ve tek "Parimet themelore" dhe më tej në seksionet e veçanta të tij: "Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve" (pika 1.4).

Nga ana tjetër, për sa kohë pala ankuese pretendonte se emisioni mund të ndikonte procesin ligjor për kujdestarinë e të miturës si dhe duke pasur parasysh interesin më të lartë të së miturës, znj. E.Ç do duhej të kishte respektuar të drejtën e përgjigjes, referuar kërkesave të nenit 53 të ligjit të sipërcituar.

Pika 4, e nenit 53, sanksionon se "Personi që ushtron të drejtën e përgjigjes, në përputhje me rregulloren, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit përgjegjës të shërbimit mediatik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij".

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, kërkoi ndalimin e ritransmetimit të emisionit, si dhe respektimin e së drejtës së përgjigjes për palën ankuese në OSHMA-në përkatëse.

Ankesa e paraqitur nga: **E.I**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Klan"	Emisioni "Klanifornia"	05.06.2021
TV "Abc News"	Emisioni "Pasdite"	10.06.2021
TV "Abc News"	Emisioni "Kosherja show"	13.06.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Drejtuesi i dy fondacioneve "The HeadHunter Group" dhe "Dignity Global", shtetasi E.I i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave, për përmbajtje, sipas tij "homofobike dhe diskriminuese ndaj komunitetit LGBT", të disa transmetimeve audiovizive. Konkretisht, ankesa i referohej programit "Pasdite" transmetuar në televizionin "Abc News", më datë 10.06.2021. Emision gjatë të cilit pretendohet se ishte thënë se "LGBT ka kërkuar heqjen e termave "Nënë" dhe "Baba" pa qenë e vërtetë". I njëjti ankues i referohej emisionit "Kosherja show", transmetuar në televizionin "Abc News", më datë 13.06.2021 ku pretendohet se "editoriali i interpretuar nga Bes Kallaku ishte sërish, mbi baza të pavërteta". Në emisionin "Klanifornia", transmetuar më datë 05.06.2021 në televizionin "Klan", ankuesi pretendonte se emisioni mbyllej me fjalën "Pederast", çka sipas tij "tregon qasje homofobike".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi materialet filmike, Këshilli i Ankesave i kërkoi OSHMA-së të respektojë të drejtën e përgjigjes. Referuar nenit 53 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, çdo shtetasi i garantohet mundësia e së drejtës së përgjigjes. Kjo e drejtë garantohet edhe nga Rregullorja "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes. Neni 11 i kësaj Rregulloreje përcakton se "Çdo person fizik apo juridik, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga pub-

likimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim, ka të drejtën e përgjigjes". Rregullorja e sipërcituar përcakton gjithashtu se:

"OSHMA-ja, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes; Nëse është e nevojshme, OSHMA-ja ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga kërkuesi lidhur me pretendimet e ngritura për cenimin e dinjitetit dhe reputacionit; OSHMA-ja njofton me shkrim kërkuesin lidhur me vendimin e marrë si më sipër; Nëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kërkuesi nuk merr një përgjigje, prezumohet se OSHMA-ja ka refuzuar kërkesën (Neni 12, pikat 1,2,3 dhe 4)".

Bazuar në nenin 13, pika 1 i së njëjtës Rregullore, kur OSHMA-ja vendos për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes, ajo duhet të transmetojë përgjigjen brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Në ankesën e dytë, ku ankuesi pretendonte se ka pasur qasje homofobike, Këshilli i Ankesave i kërkoi OSHMA-së respektimin e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit për median audiovizive, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017, neni 32, "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe /ose audiovizive", sipas të cilit "OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi" (pika 4) dhe neni 33, i cili duke përcaktuar detyrimet e OSHMA-ve, vëren, se "Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të

mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut (pika 1, germa ç).

Edhe në Seksionin 1 të Kodit të Transmetimit, "Parimet themelore", përcaktohet se "Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, garantojnë e respektojnë lirinë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes..., dhe nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve" (pika 1.1 dhe 1.5). Në vendimmarrjen e saj, Këshilli i Ankesave nënvizoi, se AMA "mbështet lirinë e çdo individi për të shprehur lirisht mendimet e veta pro dhe kundër çështjes në fjalë, por dënon kategorikisht çdo deklaratë apo prononcim që e kthen debatin në diskriminim, agresion apo dhunë". Ndaj, Këshilli i Ankesave u kërkoi OSHMA-ve respektimin e normave ligjore dhe etike në transmetimet e ardhshme, gjithashtu korrigjimin e lajmeve të mundshme të pavërteta dhe shmangien e gjuhës së urrejtjes e të diskriminimit që ka pasuar këtë debat.

2

Ankesa me
objekt
"Cënimin e
të drejtave
të femijëve"

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Top Channel"	Emisioni "Shqipëria live"	04.01.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori dhjetëra ankesa në lidhje me emisionin "Shqipëria live", të transmetuar më datë 04.01.2021, në televizionin "Top Channel". Ankuesit pretendonin se ishte shkelur e drejta dhe privatësia e një të mituri 14-vjeçar gjatë transmetimit të intervistës, mbi vrasjen e nënës së tij, nga banesa dhe vendi i krimit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi me kujdes materialin filmik, konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive. Konkretisht, intervistimi i të miturit në zbulim të plotë të identitetit të tij, që tregonte detaje nga vendngjarja për vrasjen ku ishte dëshmitar, cenonte rëndë interesin e të miturit dhe në këto kushte nuk duhej të ishte transmetuar pasi rrezikohet zhvillimi moral dhe fizik i tij.

Në nenin 4 të ligjit nr.97/2013, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive. 1. Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parimeve", në pikën b) sanksionohet se "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve".

OSHMA-së iu rikujtuan edhe përcaktimet e Kodit të Transmetimit, sipas të cilave:

"5.1 OSHMA-ve u ndalohej çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në iden-

tifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve me interes publik". 5.2 Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare. Ndalohet intervistimi i fëmijës që mund të jetë përfshirë në një ngjarje të rëndë: p.sh fëmijë të larguar nga familja, që kanë tentuar të vrasin veten, që janë përdorur nga grupe kriminale, që kanë qenë brenda një rrjeti prostitucioni, që i kanë prindërit të dënuar".

Këshilli i Ankesave çmoi se intervistimi i të miturit, në kushtet kur ai rrëfente ngjarjen e rëndë kriminale, në vendin e ngjarjes, ishte shkelje e rëndë e Kodit të Transmetimit ndaj dhe nuk duhej të ishte transmetuar. Ai vlerësoi se transmetimi, sjell dëme serioze për shëndetin e të miturit ndërkohë që transmetimet audiovizive duhet të kenë prioritet interesin e fëmijëve.

Bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së, kërkoi ndalimin e çdo ritransmetimi të kësaj interviste si dhe respektimin e Kodit të Transmetimit në përmbajtjet e ardhshme audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **Ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "News 24" TV "Abc News"	Edicione informative	21.01.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s mori një ankesë, sipas të cilës në edicionet informative të televizioneve "Abc News" dhe "News 24" ishte transmetuar intervista e një nëne, vajza e së cilës ishte abuzuar seksualisht. Ankesa i referohej rastit të ndodhur në qytetin e Kuçovës ku një person u arrestua, pasi dyshohej se kishte abuzuar seksualisht me një vajzë të mitur 10-vjeçare. Sipas ankesës, intervista e nënës së vajzës së mitur, pa fshehur identitetin e saj, bashkë me pamjet e banesës, kishin shkelur rëndë privatësinë dhe dinjitetin e fëmijës së dhunuar.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi pamjet filmike të edicioneve informative dhe kronikave televizive, evidentoi se transmetimi i kronikës identifikonte vajzën e dhunuar në shkelje të rëndë të Kodit të Transmetimit, që ndalon çdo transmetim që mund të ekspozojë fëmijët që janë viktimë e një krimi, pasi mund të dëmtojë rritjen e tyre.

5.1 "OSHMA-ve u ndalohej çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve me interes publik".

5.2 "Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare. Ndalohet

intervistimi i fëmijës që mund të jetë përfshirë në një ngjarje të rëndë: p.sh fëmijë të larguar nga familja, që kanë tentuar të vrasin veten, që janë përdorur nga grupe kriminale, që kanë qenë brenda një rrjeti prostitucioni, që i kanë prindërit të dënuar".

Bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive u tërhoqi vëmendjen OSHMA-ve dhe kërkoi ndalimin e çdo ritransmetimi të kronikës televizive, kërkoi respektimin e Kodit të Transmetimit në përmbajtjet e ardhshme audiovizive duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve dhe interesin publik.

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Vizion Plus"	Emisioni "Binjakët"	04.02.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, mori disa ankesa në lidhje me dy edicione të emisionit "Binjakët", të transmetuar më datë 31.12.2021 dhe me datë 17.01.2021 në televizionin "Vizion Plus". Sipas njërës prej ankuesve, në emisionin e datës 31.12.2020 ishin përdorur fjalë joetike. Ndërsa ankesa tjetër i referohej emisionit të datës 17.01.2021, ku pretendohet se ishin përmendur emrat e dy faqeve pornografike, "Brazzers" dhe "Bangbros".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi me kujdes materialin filmik, Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të ligjit dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive.

Pavarësisht natyrës argëtuese të emisionit, Këshilli i Ankesave evidentoi se përmendja e faqeve pornografike në atë orar dëmton fëmijët. Për më tepër që, për orarin e transmetimit, duheshin marrë masat e duhura teknike për vendosjen e shenjave paralajmëruese sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit.

Referuar ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, te parimet themelore përcaktohet se "Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parimeve: veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton...personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve" (neni 4, pika 1, germa b). Këto parime dhe detyrime janë të mirëpërcak-

tuara nga Kodi i Transmetimit, në seksionin 1 "Parimet themelore", të cilat përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, ndaj u kërkohej OSHMA-ve "të respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të respektojnë në mënyrë të veçantë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat morale ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve".

Edhe në pikën 5.31 të Kodit të Transmetimit në nënseksionin "Programet argëtuese, filmat dhe fëmijët", Kodi sanksionon se "OSHMA-të, në programet kulturore e argëtuese, veçanërisht në paraqitjen e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale, duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë së publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve".

Bazuar në sa më sipër, AMA tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit. Gjithashtu i kërkoi marrjen e masave të duhura teknike, si dhe vendosjen e shenjave paralajmëruese sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Top Channel"	Emisioni "Shqipëria live"	20.05.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave (AMA) mori një ankesë nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHMDF) për emisionin "Shqipëria Live", të transmetuar në televizionin "Top Channel", më 14.05.2021. Shqetësimi i specialistëve të agjencisë erdhi pas intervistimit të një 14 vjeçareje, e cila ishte në proces menaxhimi dhe po trajtohej nga struktura e Mbrojtjes së Fëmijës në Bashkinë e Tiranës. Në ankesën e tyre ata pretendonin se "vajza ka bërë kallëzim penal dhe ka një urdher mbrojtjeje ndaj babait. Ky i fundit, sipas punonjësës së mbrojtjes së fëmijës që po trajton vajzën, dyshohet që ka dhënë prononcime të pavërteta në media, duke akuzuar vajzën dhe nënën e saj për një sërë ngjarjesh....".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi pamjet filmike dhe përmbajtjen e emisionit ku u trajtua rasti dhe konstatoi se:

"Intervistimi i babait të së miturës së përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare çonte në identifikimin e tërthortë të saj, identifikim i ndaluar nga Kodi i Transmetimit për median audiovizive, i miratuar me Vendimin e AMA-s, datë 11.12.2017; Gjatë emisionit dhe intervistës u publikuan detaje të panevojshme për rastin në fjalë, që gjithashtu çonte drejt identifikimit të tërthortë të të miturës".

Seksioni 5 i Kodit të Transmetimit, "Fëmijët në transmetimet audiovizive" përcakton qartësisht se: "Të dhënat e publikuara për fëmijët në media duhet të shmangin: identifikimin dhe inicialet e fëmijës; identitetin e prindërve, apo të çdo të afërmi që bën të mundur identifikimin e

fëmijës; rrethana, detaje mbi ngjarjen, që bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës, cenonjë dinjitetin e tij dhe nuk i shërbejnë interesit publik; emër shkolle, kopshti, institucioni në rastet kur situata e abuzimit apo veprës penale nuk kanë ndodhur në institucion; emrin e autorit të krimit, i cili ka marrëdhënie gjaku me viktimën" (pika 5.4); "Kujdes duhet treguar edhe me raportimin dhe transmetimin e palëve të treta jo fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës..." (pika 5.5).

Këshilli i Ankesave vlerësoi se identifikimi i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë i të miturve ishte pengesë për rehabilitimin dhe integrimin e tyre në shoqëri në të ardhmen.

Nisur nga fakti, që trajtimi i problemeve dhe dukurive të tilla sociale mbart interes publik, Këshilli i Ankesave i rikujtoi OSHMA-së respektimin e Kodit të Transmetimit për median audiovizive, sidomos në rastet e trajtimit të çështjeve për dhe rreth të miturve, gjithnjë duke mbajtur nën vëmendje interesin më të lartë të fëmijës si dhe duke respektuar privatësinë dhe dinjitetin e tyre.

3

Ankesa me
objekt
jashtë
juridiksionit
të ANA-s

Ankesa e paraqitur nga: **Studio ligjore**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Portali "Pamfleti"	Shkrim	28.12.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, mori një ankesë nga përfaqësuesi ligjor i shtetasit M.M, i cili pretendonte se artikulli i publikuar më datë 21.12.2020, në portalin "Pamfleti", me titull "Genti i KLP-së kërcënon "Pamfletin" si në kohën e Nesipit do të pastrojë lidhjet e zeza të prokurorës Mërtiri me krimin", kishte cenuar rëndë emrin dhe reputacionin e klientit të tij. Sipas ankuesit, "në shkrim aludohet se shtetasi M.M është i përfshirë në aktivitete kriminale brenda dhe jashtë vendit dhe biznesin e landfilleve në Shqipëri duke i lidhur këto të fundit me familjarët e tij" dhe se këto informacione ishin të pavërteta.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa ishte jashtë objektit të punës së AMA-s, referuar ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, i cili përcakton se "ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj zbatohet për median e shkruar". Pra, ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar dhe as për mediat/rrjetet sociale/portalet, siç ishte rasti i portalit "Pamfleti", ndaj të cilit ishte drejtuar ankesa.

Në kuptim të përkufizimeve në ligjin e sipërcituar, "Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSH-MA) është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj" (neni 3, pika 17 "Përkufizime").

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave u shpreh se duke qenë se portali "Pamfleti" nuk i takon një medieje audiovizive, ankesa ishte jashtë objektit të punës së AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga: **Studio ligjore**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Portale online	Shkrime	17.03.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Shoqëria "Mektrin Motors", sh.p.k e përfaqësuar nga av. A.B i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave. Ankuesi pretendonte se disa portale online si "prize.al" dhe "gazetadita.al", kishin publikuar shkrime "të pavërteta" dhe "shpifëse" rreth aktivitetit të shoqërisë tregtare duke i cenuar imazhin dhe reputacionin e kompanisë.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi ankesën dhe materialin shoqëruar të saj, Këshilli i Ankesave iu përgjigj se mediat e sipërcituara si dhe portalet online janë jashtë juridiksionit të AMA-s, referuar këtu ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2 ("Fusha e zbatimit") i cili përcakton se, "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre".

Ankesa e paraqitur nga:

Disa ankues

Subjekti audioviziv

RTSH Shqip

Programi

Film

Data

25.05.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive u depozituan disa ankesa për një film të transmetuar në kanalën "RTSH Shqip", më datë 21.05.2021 në orën 18:00. Sipas ankuesve, filmi i transmetuar kishte "skena të forta erotike", "skena porno" dhe "ka thyer rëndë etikën televizive".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s shqyrtoi programin përkatës të transmetuar, përkatësisht në minutat 18:00:01 deri 18:02:40, ku konstatoi skena erotike dhe seksuale. Transmetimi i skenave të tilla, në një orar që mund të ndiqej edhe nga fëmijët u vlerësua nga Këshilli i Ankesave si shkelje e parimeve ligjore dhe etike për transmetimet audiovizive. Konkretisht, përcaktohet se "Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv duhet të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror" (Detyrimet e OSHMA-ve, neni 33, pika 1, germa e, ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar).

Gjithashtu, transmetimi i skenave të forta erotike dhe seksuale në orare jashtë përcaktimeve të Kodit të Transmetimeve, bie ndesh me Kodin e Transmetimit dhe aktet nënligjore të miratuara nga AMA, vendimi nr.228, datë 11.12.2017, në seksionin 1 të tij, "Parimet themelore", pika 1.13 përcakton qartësisht se : "Transmetimet audiovizive elementë pornografisë apo dhunës së skajshme, duhet

t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të krijuara. Asnjë përmbajtje pornografike nuk duhet të transmetohet në oraret kur programet ndiqen prej fëmijëve".

Duke pasur në konsideratë interesin më të madh të fëmijës, Kodi i Transmetimit nuk u lejon OSHMA-ve "të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, përveç rasteve kur sigurohet, duke zgjedhur orarin e transmetimit ose ndonjë masë tjetër teknike, që të miturit të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime (Ora kufi 22:00-06:00). Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen për të mos përsëritur raste të tilla që bien ndesh me kërkesat ligjore dhe parimet e Kodit të Transmetimit, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve në çdo transmetim të ardhshëm.



Ankesa me objekt të ndryshëm

Ankesa e paraqitur nga:

Disa ankues

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV "Top Channel"

Rubrika "Rrethi katror"

29.01.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Këshillit të Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) mbërritën disa ankesa dhe shqetësime lidhur me deklaratimet e një ftuari në rubrikën "Rrethi katror", transmetuar në televizionin "Top Channel". Sipas ankesave, i ftuari A.C. herë pas here në emisionin e sipërcituar, kishte bërë deklaratime për situatën globale të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 dhe për vaksinën kundër këtij virusi. Ai ishte shprehur se "Ky virus, ky mutacion është futur përmes vaksinës. Kemi 13 të vdekur, 6 nga vaksina dhe 7 nga një lloj medikamenti që bëhet para marrjes së vaksinës. Kur të bëhet vaksina, duhet të nënshkruash. Vaksina ka një numër serie... Kush bën vaksinën mbi 65 vjeç, mbi 90% janë të eliminuar, do vdesin. Të rinjtë, një pjesë, do të bëhen impotentë. Një pjesë tjetër do t'i ndryshojë orientimi seksual...".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi materialin filmik, AMA i kërkoi zyrtarisht Institutit të Shëndetit Publik një vlerësim mbi efektet dhe ndikimet e qëndrimeve të tilla publike rreth procesit të vaksinimit kundër Covid -19. Në përgjigjen e tyre specialistët e ISHP-së nënvizuan dëmin që shkaktohej tek publiku i gjerë nga deklaratime të tilla, si ato të z. A.C.

OSHMA-të kanë detyrime që "të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për të gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme", (ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 33, pika b).

Gjithashtu, edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017 në pikën 3.5 të tij i kërkon OSHMA-ve "Mbrotjen e shëndetit publik dhe të sigurisë".

Bazuar në sa më sipër, AMA çmoi se deklaratimet e sipërcituara të z.A.C ishin shqetësuese, të dëmshme për shëndetin publik si dhe në shkelje të normave ligjore dhe parimeve etike. Ndaj dhe vendosi tërheqjen e vëmendjes ndaj OSHMA-së dhe në rast përsëritje, vendosjen e sanksioneve sipas parashikimeve ligjore.

Ankesa e paraqitur nga:

Policia Ushtarake, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

Subjekti audioviziv

TV "Abc News"

Programi

Emisioni "Vetting"

Data

25.03.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

A.K, kolonel komandant në Policinë Ushtarake, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave mbi emisionin "Vetting", transmetuar në televizionin "Abc News", më datë 16.03.2021. Sipas ankuesit "gjatë transmetimit të këtij programi janë dhënë pamje vizive, dokumentacione dhe deklarata nga ushtaraku A.Ç të cilat në tërësinë e tyre cenojnë, gatishmërinë luftarake, aktivitetin dhe operacionalitetin ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe Sigurinë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Referuar ankesës, ku pretendohet se "ishte cenuar siguria kombëtare përmes transmetimeve audiovizive, në formën e deklarimeve dhe transmetimeve të pamjeve", Këshilli i Ankesave i ktheu përgjigje ankuesit ku e vinte në dijeni se "OSHMA-ja kishte hequr materialin përkatës filmik nga kanali zyrtar në "Youtube". Ndërkohë i kujtoi ankuesit se për të vijuar më tej me trajtimin e ankesës, nevojitej të specifikonte konkretisht ku ishte cenuar apo mund të cenohet siguria kombëtare.

Fund

**AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.
www.ama.gov.al

këtej, mbështetur në Kodin
të miratuar nga A
e Audiovizive i cili përm
parimet, rregullat, kërkes
e transmetimeve audioviz
ën e Shqipërisë, Këshilli i
n të vëzhgojë me kujdes se
të mirëpërcaktuara për p
tëmet audiovizive zbatoh
i Këshillit të Ankesave i
kohësh ka qenë i mundur
audioviziv si këshillues i pë
meve audiovizive, është n
të cilin raportohen resul
vara nëpërmjet të cilave dy
parimet, rregullat, kërkesat